

ADTN sh.a

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TËTË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-13



ADTN sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 202019
AKTIVE			
Aktivët afatshkurtra			
Mjetet monetare në arkë e në bankë	4	102,767,180	3,318,980
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	174,272,006	39,687,570
Llogari të arkëtueshme të tjera	6	495,812	434,814
Totali i aktiveve afatshkurtra		277,534,998	43,441,364
Aktivët afatgjata			
Totali i aktiveve afatgjata të luajtshme		1,744,583	-
Totali i aktiveve		279,279,581	43,441,364
KAPITALI			
Kapitali aksionar	7	3,500,000	3,500,000
Humbje të mbartura		(21,842,478)	(23,396,276)
Fitimi i ushtrimit		11,298,155	1,553,798
Totali i kapitalit		(7,044,323)	(18,342,478)
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	8	246,745,669	29,330,558
Detyrime tatimore	9	2,317,071	670,740
Llogari të pagueshme ndaj paleve të lidhura	10	37,260,163	31,762,544
Totali i detyrimeve afatshkurtra		286,322,903	61,783,842
Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		286,322,903	61,783,842
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		279,279,581	43,441,364

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese të faqeve 5-12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	414,999,415	43,690,475
Të ardhura të tjera			
Total të ardhura		414,999,415	43,690,475
Materiale dhe shërbime direkte	12	(349,051,914)	(27,761,451)
Shpenzime personeli	13	(13,704,784)	(11,896,668)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		(138,971)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	14	(40,805,591)	(2,481,648)
Total shpenzime		(403,701,260)	(29,450,598)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)			3,090
Shpenzime të tjera financiare (neto)			
Fitimi/humbja para tatimit		11,298,155	1,553,798
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		11,298,155	1,553,798
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	13	11,298,155	1,553,798

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5-12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare



ADTN sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali aksionar	Rezerva përkthimi	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura/humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 01 janar 2020	3,500,000	-	-	(23,396,276)	1,553,798	(18,342,478)
Fitime / Humbje te mbartura				1,553,798	(1553,798)	
Fitim/ Humbje e periudhes					11,298,155	11,298,155
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2020,	3,500,000	-	-	(21,842,478)	11,298,155	(7,044,323)
Fitime / Humbje te mbartura						
Fitim/ Humbje e periudhes						
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 202	3,500,000	-	-	(21,842,478)	11,298,155	(7,044,323)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 –12 , të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori i ADTN sh.a më 20 Mars 2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:



Znj. LAURETA ALIKAJ
Hartuesi Pasqyrave Financiare





Z. Andi Cenko
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	11,298,155	1,553,798
Axhustime per zerat jo-monetare: Ndryshimi ne kapitalin qarkullues		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(134,645,434)	(19,662,384)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	224,540,060	20,210,826
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ	101,192,782	2,102,240
Aktivitetet investuese	(1,744,583)	
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	-	-
Aktivitetet financuese		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	-	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	99,448,199,	2,102,240
Mjetet monetare në fillim të periudhës	3,318,980	1,216,740
Diferenca përkthimi		
Mjetet monetare në fund të periudhës	102,767,180	3,318,980

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 –12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare



ADTN sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

ADTN sh.a ("Shoqëria") është themeluar më 13.09.2016, regjistruar më 21.09.2016 në QKR. Më 31 dhjetor 2019 pronësia e kapitalit zotërohet nga Digitalb sha .

Kapitali i Shoqërisë është 3,500,000 lekë

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit, prodhimi i shërbimeve audio dhe video.

Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë është z. Andi Cenko .

Shoqëria drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës i cili përbëhet nga :

- Dritan Shakohoxha
- Eni Ahmati
- Bledar Hoxha

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "Pavarësia", Nr. 39, Kashar, Tiranë.

Shoqëria është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT L62121006Q

Shoqëria më 31 dhjetor 2019 ka 10 punonjës të regjistruar (në 31.12.18 kishte 15 punonjës) .

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25, datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.



2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.5.1 Zhvlerësimi i logarivetë arkëtueshme

Zhvlerësimi i logarivetë arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuaratë cilat rezultojnë ngapamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e logarivetë arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë së paguesetë konsumatorëve, sidhëndryshimet e fundit dhe të pritshmetë termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se kanëvojë për zhvlerësimin e logarivetë arkëtueshme.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit
EUR/LEK
USD/LEK



31 dhjetor 2020

123.7

100.84

31 dhjetor 2018

121,77

108,64

3.2 Instrumentat financiarë

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë .

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë



3.4 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.5 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka bërë diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.



3.8 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.9 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.10 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.11 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme

që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.12 Krahasueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën e pozicionit financiar si edhe në pasqyrën e fitim humbjes.

4. Mjete monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim :



ADTN sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	107,722,070	3,318,980
Mjete monetare në arkë	45,110	
	<u>107,767,180</u>	<u>3,318,980</u>

5. Llogari te arketueshme tregtare

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim :

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kliente rrjeti tokësor	174,272,006	39,687,570
	<u>174,272,006</u>	<u>39,687,580</u>

6. Llogari te arketueshme te tjera

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Debitore te ndryshem	495,812	434,814
	<u>495,812</u>	<u>434,814</u>

7. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është në vlerën 3,500,000 Lekë, i cili zotërohet nga aksionerii shoqërisë.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri aksioneve	1	1
Vlera nominale	3,500,000	3,500,000
	<u>3,500,000</u>	<u>3,500,000</u>

Humbja e mbartur më 31 dhjetor 2019 është : (21,842,478) Leke ,
Rezultati i ushtrimit me 31 dhjetor 2020 është 11,298,155

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:



(Vlerat janë në Lek)

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme tregtare	246,745,669	29,330,557
	<u>246,745,669</u>	<u>29,330,557</u>

9. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	409,953	208,301
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	161,586	130,772
TVSH për tu paguar	1745,532	351,667
	<u>2,317,071</u>	<u>690,740</u>

10. Llogari të tjera të pagueshme ndaj paleve të lidhura

Llogari të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 si më poshtë:


	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme ndaj shoqërisë Digitalb	37,260,163	31,762,544
	<u>37,260,163</u>	<u>31,762,544</u>

11. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Te ardhura nga aktiviteti	414,999,415	43,690,475
	<u>414,999,415</u>	<u>43,690,475</u>

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në



(Vlerat janë në Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Qarkullimi i tatueshem	414,999,415
Sipas kontabilitetit	414,999,415
Diferenca	-

12. Materiale dhe sherbime direkte

Materiale dhe sherbime direkte për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Licensa dhe shpenzime te rrjetit tokësor	349,051,914	27,761,451
	<u>349,051,914</u>	<u>27,761,451</u>

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	12,254,692	10,462,649
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,450,092	1,434,019
	<u>13,704,784</u>	<u>11,896,668</u>

14. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime qeraje	500,002	500,000
Shërbime nga të tretë dhe mirembajtje	553,710	1,643
Taksa vendore	112,100	101,000
Komisione bankare	72,982	7,305
Shpenzime konsulence dhe auditimi	125,390	120,000
Shpenzime te ndryshme	53,285,162	60,036
	<u>54,774,736</u>	<u>789,984</u>



15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 :

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	11,298,155	1,553,798
Shpenzime te panjohura te tjera	56,007	1,708,558
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	<u>11,354,155</u>	<u>3,262,356</u>
Humbje fiskale e mbartur	(21,842,478)	(23,278,207)
Fitim/Humbje e tatueshme	(10,488,323)	(20,015,851)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
Fitimi Neto pas tatimit	<u><u>11,298,155</u></u>	<u><u>1,553,798</u></u>

